




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D / DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-1338/13
Dep. Dep. 02	Prot No. 07-05-2013
Nr. i faq. Broj stranica	Data Datum
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.04.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-457\1, për zyrtarin e lartë z. Osman Kozmaqi, Drejtor në NPH- IBER LEPENCI- Prishtinë, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-457/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Osman Kozmaqi, Drejtor në NPH- IBER LEPENCI- Prishtinë, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron edhe pozitën e personit të autorizuar dhe pronarit në një kompani private "PRO-LEX-L.L.C" Prishtinë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 05.03.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Kozmaqi, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës është organizuar takimi me z. Kozmaqi, me datën 13.03.2013, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjate takimit zyrtari në fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Drejtorit në NPH- IBER

LEPENC, dhe ka te regjistruar një Kompani privatë me emër "PRO-LEX-L.L.C" ku është pronarë dhe person i autorizuar.

Ne takimin e mbajtur zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se ne afat sa me te shpejtë do të bejë ndryshimet dhe do ta autorizoj një person qe ta udhëheqë me kompaninë e regjistruar, dhe do ta shmange çfarë do suate qe munde te shkaktoj konflikt te interesit.

Zyrtari i lartë me datën 17.04.2013, ka sjellë në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka bartur tek personi i besuar të drejtën e drejtimit te kompanisë.

Duke u bazuar ne dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z.Osman Kozmaqi, Drejtor në NPH-IBER LEPENC, Konstatojmë se : zyrtari i lartë z.Osman Kozmaqi, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

